



Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

**Përmbledhje e gjetjeve për qarqet e Tiranës, Dibrës,
Kukësit dhe Shkodrës**

SHTATOR 2022

Autorë: [Deanna Davy](#), Konsulente ndërkombëtare për UNICEF Shqipëri
[Blerina Metanaj](#), IDRA Shqipëri

Drejtues i Studimit: [Elda Denaj](#), Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit në UNICEF Shqipëri

Editor: [Iain Wilson](#)

Ky dokument është përgatitur në kuadër të programit *Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria*, zbatuar nga një koalicion i gjashtë organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare: UNICEF Shqipëri, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Prezenca në Shqipëri, Terre des Hommes, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Programi financohet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (MB).

Pikëpamjet e shprehura në raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të UNICEF-it ose të pozicioneve të zyrtarëve të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materiale nga ky raport për botimet e tyre. Si mbajtës i së drejtës së autorit, UNICEF-i në Shqipëri kërkon përmendjen e duhur dhe një kopje të botimit.

Citim i sugjeruar i raportit:

Davy, D., dhe Metanaj, B. (2022) “Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë : Vala e dytë. Përmbledhje e gjetjeve për qarqet e Tiranës, Dibrës, Kukësit dhe Shkodrës” UNICEF-I Shqipëri dhe IDRA.

Për komente dhe sugjerime ju lutem shkruani në adresën elektronike tirana@unicef.org

Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

Përmbledhje e gjetjeve për qarqet e Tiranës,
Dibrës, Kukësit dhe Shkodrës

Shtator 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---------------------------------|----|
| 1. HYRJE | 4 |
| 2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT | 5 |
| 3. METODOLOGJIA | 6 |
| 4. GJETJET: PJESA A..... | 9 |
| 5. GJETJET: PJESA B..... | 22 |
| 6. PËRFUNDIME | 26 |

1. HYRJE

Shqipëria është prekur ndjeshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe vazhdon të zhvillojë një sërë politikash dhe mekanizmash për ta luftuar këtë fenomen. Vendi njihet si vendburim për trafikimin e qenieve njerëzore. Shqiptarët trafikohen shpesh drejt Italisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Gjermanisë dhe Zvicrës nëpërmjet rrjeteve të organizuara kriminale. Ndërkohë, trafikimi brenda vendit vijon të jetë një fenomen i konsiderueshëm prej rreth dy dekadash, shumica e viktimave vendase të të cilit janë fëmijë dhe të rinj. Shumë viktima shqiptare vijnë nga familje të varfra, janë të papunë dhe me mangësi në arsimim. Për fëmijët dhe të rinjtë e trafikuar, faktorët e riskut e kanë zanafillën kryesisht nga situatat familjare, dhe përfshijnë braktisjen ose shpërbërjen e familjes. Pasojë e këtyre faktorëve është fakti që atyre iu mungojnë rrjetet e rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtës.

Pavarësisht të dhënave të qarta se të rinjtë shqiptarë janë të cenueshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore, ka mungesë literature për nivelin e njohurive të tyre për këtë fenomen brenda vendit, ose për qëndrimet dhe praktikatat e tyre lidhur me të. Vetëm një studim i fundit (2016) trajton njohuritë dhe ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri.¹ Nga ai studim, kuptojmë se të rriturit shqiptarë janë më të ndërgjegjshëm rreth trafikimit për qëllime seksuale sesa rreth trafikimit për qëllime pune; më shumë se gjysma e të rriturve shqiptarë të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është problem serioz, por prek kryesisht gratë dhe fëmijët; dhe se shumë persona nuk dinë se si mund t'i ndihmojnë viktimat e mundshme.

Duke qenë se ai studim nuk trajtoi posaçërisht nivelin e njohurive të të rinjve, ose qëndrimet dhe praktikatat e tyre lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, studimi aktual e shqyrton këtë çështje me qëllim plotësimin e mangësive të rëndësishme në njohuri. Rezultatet e studimit do të jenë të dobishme për qeverinë dhe palët joqeveritare të interesit që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Studimi aktual është një anketë e valës së dytë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të vendit, dhe te romët. Kjo anketë pason atë të valës së parë, rezultatet e së cilës u publikuan në dhjetor të vitit 2020.² Kjo anketë e valës së dytë përsërit pyetjet e valës së parë në masën maksimale të mundshme.

Ky raport fokusohet te rezultatet e anketës për të gjithë të rinjtë e anketuar në katër qarqet e synuara të Shqipërisë. Ai shoqërohet nga katër raporte për qarqet dhe një raport për romët. Për analizë të mëtejshme, të dhënat e mbledhura nga anketa e valës së dytë mbahen dhe vizualizohen në një panel të posaçëm.³

Raporti ka dy qëllime: 1) të paraqesë gjetjet mbi të dhënat me qëllim mundësimin e një panorame të përgjithshme të situatës aktuale sa u përket njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në vitin 2022, dhe 2) të krahasojë treguesit e rëndësishëm të ndryshimit të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore si rezultat i materialeve të komunikimit nga UNICEF-i.

Duhet theksuar se, në këtë raport janë kryer vetëm disa krahasime ndërmjet rezultateve të anketës së valës së parë dhe valës së dytë, për arsytet e mëposhtme: (1) Ndryshimet e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave ishin kryesisht minimale; (2) pyetësi në anketën e valës së dytë pati ndryshime të vogla (për të shmangur disa nga vështirësitë e hasura gjatë analizimit të të dhënave të valës së parë); (3) për të lehtësuar të kuptuarit të të dhënave dhe gjetjeve për lexuesit (krahasimi i tepërt do të kërkonte një raport të gjatë, që do të ishte shumë i ngarkuar dhe i vështirë për t'u ndjekur lehtësisht nga lexuesit). Megjithatë, për pyetjet kryesore, krahasimi i rezultateve ndërmjet dy valëve është përfshirë në Pjesën B të këtij raporti.

¹ USAID, 2016, Matja e opinionit publik lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Moldavi dhe Shqipëri duke përdorur anketa eksperimentuese për të informuar rreth programeve efektive të parandalimit dhe ndërgjegjësimin.

² Davy, D., dhe Metanj, B., 2020, [Anketë e valës së parë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë. Raport për gjetjet](#). UNICEF në Shqipëri dhe IDRA.

³ [Paneli i studimit](#)

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Nëpërmjet këtij studimi synohet të kuptohet dhe eksplorohet niveli i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në qarqet Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë, si dhe të të rinjtë romë. Këto qarqe janë përzgjedhur sepse janë qarqe burimore të njohura për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, dhe të shqiptarëve jashtë vendit.

Objektivat e studimit (vala e dytë) ishin matja e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve të anketuar lidhur me fushat vijuese:

Njohuritë

- Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore.
- Format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe në vende të huaja.
- Kush është i rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore.
- Metodatat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore.
- Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore.
- Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat

Qëndrimet

- Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.
- Qëndrimet ndaj viktimave.

Praktikat

- Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore.
- Interesi për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore.

2.1 Rezultatet e komunikimeve të UNICEF-it

- Ekspozimi ndaj materialeve për komunikim mbi trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve.
- Rritja e njohurive, qëndrimeve dhe interesit për t'u angazhuar në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rrjedhojë e ekspozimit.

2.2 Struktura e raportit

Pas këtij seksioni hyrës, raporti paraqet metodologjinë e studimit, e pasuar nga gjetjet mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore për 4 qarqet në tërësi - Tiranë, Shkodër, Kukës dhe Dibër.

Gjetjet janë ndarë në dy seksione: Pjesët A dhe B. Pjesa A paraqet gjetjet e përmbledhura, të ndara sipas seksit, moshës dhe urbanitetit të të anketuarve. Pjesa B diskuton ndryshimet pozitive të njohurive, qëndrimeve dhe synimit të të rinjve për t'u përfshirë në aktivitetet kundër trafikimit të qenieve njerëzore në të katërta qarqet. Në fund, raporti ofron përfundime të mbështetura te gjetjet.

⁴ Grupmosha 15–29 vjeç, sikurse përcaktohet nga Komisioni Evropian. Shihni EUROSTAT, Të rinjtë - Vështrim i përgjithshëm: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/youth>.

3. METODOLOGJIA

3.1 Qasja ndaj anketës

Për studimin aktual janë anketuar rreth 1,600 të rinj (Tabela 1), duke përfshirë të anketuar të grupmoshës 15-29 vjeç që jetojnë në Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë (350 të anketuar në secilin qark). Kampioni përfshiu një kampion plotësues prej 200 të rinjsh të popullatës rome që jetojnë në Kukës, Shkodër dhe Tiranë.

Të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Të dhënat zyrtare⁵ tregojnë se janë në total rreth 300,000 persona të moshës 15-29 vjeç që jetojnë në qarqet ku u krye studimi. Si rrjedhojë, madhësia e kampionit prej 1,600 të anketuar garanton rezultate përfaqësuese në nivel kombëtar me marzh gabimi prej 2.62 për qind dhe me interval besueshmërie prej 95 për qind (shihni Panelin e Anketës për përmbledhjen e metodologjisë).

Anketa u zhvillua nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë. Vetëm një person për familje, i grupmoshës 15-29 vjeç, u ftua të merrte pjesë. Përzgjedhja rastësore e familjeve u bë nëpërmjet një softueri.

Anketa nuk ishte hartuar për të përfshirë të njëjtët pjesëmarrës në të dyja etapat e mbledhjes së të dhënave, dhe nuk ka gjasë që të rinjtë pjesëmarrës në anketën e valës së dytë të jenë të njëjtët me ata të valës së parë. Gjithashtu, për arsye etike, të dhënat personale të pjesëmarrësve të valës së parë nuk u regjistruan, ndaj, këta individë nuk mund të kontaktoheshin drejtpërdrejt për valën e dytë. Pavarësisht kësaj, të dyja anketat synojnë të njëjtin profil të anketuarish: konkretisht, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç. Në të dyja anketat u ndoq i njëjti model dhe shpërndarje kampioni, dhe u zhvilluan në të njëjtat qarqe me një kampion përfaqësues në përgjithësi dhe në nivelin e katër qarqeve. Këto elemente sigurojnë krahasueshmëri të rezultateve nga vala e parë dhe e dytë.

Mbledhja e të dhënave u krye gjatë periudhës 14 janar deri më 1 mars 2022 nga intervistues të trajnuar të IDRA Research & Consulting. Çdo intervistë zgjati rreth 20 minuta. Pyetësi i valës së dytë pësoi disa ndryshime të vogla, për të pasqyruar vërejtjet dhe mësimet e nxjerra nga vala e parë. Në disa raste, të pyeturit rreth profilit të një trafikanti me pyetje të thjeshta 'Po' ose 'Jo' rezultoi në të dhëna të kufizuara për analizim. Në valën e dytë, këto pyetje u transformuan në pohime me të cilat të anketuarit duhet të binin ose jo dakord. Gjithashtu, u përdor dhe një shkallë Likert-i për të mbledhur sa më shumë të dhëna për analizim. Disa nga pyetjet që trajtonin nivelin e përfshirjes në aktivitetet kundër trafikimit të qenieve njerëzore u rishikuan për të përcaktuar dhe matur pjesëmarrjen aktive në vend të asaj pasive në këto aktivitete (p.sh., parja e një filmi ose leximi i një libri rreth trafikimit të qenieve njerëzore).

Krahas kësaj, disa pyetje u hoqën nga anketa e valës së dytë, si pyetja e pjesëmarrësve për kushtet që mund të çojnë në trafikim të qenieve njerëzore. Rezultatet nga vala e parë treguan se varfëria dhe të qenët të papunë konsiderohen si kushtet kryesore të lidhura me këtë fenomen në Shqipëri. Duke qenë se të dyja anketat janë zhvilluar gjatë një periudhe dyvjeçare, përfshirja sërish e pyetjes lidhur me kushtet që mund të çojnë drejt trafikimit në valën e dytë do të ishte e panevojshme dhe pa vlerë të shtuar për kërkimin.

Gjithsesi, anketa e valës së dytë përfshiu disa pyetje konkrete të hartuara për të zhvilluar disa tregues për monitorimin e efektit të punës komunikuese të kryer nga UNICEF-i pas anketës së valës së parë. Këto pyetje janë të rëndësishme për të kuptuar jo vetëm përqindjet e të rinjve të anketuar që ishin në kontakt me këto materiale/mesazhe, por edhe sa u përket efekteve që këto materiale/mesazhe mund të kenë pasur te njohuritë dhe qëndrimet e pjesëmarrësve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.

Tabela .1. Numri i intervistave të anketës të kryera në secilin qark të synuar dhe me romët

| Qarku | Nr. |
|-------------------------------------|--------------|
| Tiranë | 350 |
| Shkodër | 350 |
| Kukës | 341 |
| Dibër | 346 |
| Totali, 4 qarqe | 1,387 |
| Rom/e | 200 |
| Totali i të anketuarve (Nr.) | 1,587 |

⁵ Instituti i Statistikave i Shqipërisë: Rezultatet nga Censusi i vitit 2011; Adresa, aksesuar për herë të fundit: Korrik 2022: <http://www.instat.gov.al/en/themes/censuses/census-of-population-and-housing/#tab2>

3.2 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u krye nga IDRA duke përdorur paketën softuerike të të dhënave statistikore IBM SPSS 25. Të dhënat u ponderuan për të qenë përfaqësuese për secilin qark dhe në tërësi. Kjo u bë në mënyrë që kontributi i të anketuarve nga secili qark të ishte përpjesëtimor me shifrat e popullsisë së qarkut. Rezultatet u ndanë sipas treguesve demografikë kryesorë, si gjinia dhe mosha.

3.3 Konsideratat etike

Anketa për trafikimin e qenieve njerëzore nuk përmbante pyetje të vështira ose të ndjeshme për të rinjtë. Megjithatë, u krye një vlerësim i etikës, pasi të dhënat u mbledhën nga fëmijë të grupmoshës 15-17 vjeç dhe më të rritur (18-29 vjeç). Përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, studimi mori miratimin etik nga Health Media Lab. Ltd. Bordi i Rishikimit të Etikës.⁶

Për këtë studim, ekipi respektoi sa më poshtë:

- Rregulloren “Për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese”, dhe, në veçanti, nenin 1.1.4, që u kërkon institucioneve “të ruajnë një klimë bashkëpunimi që nxit përgjegjshmëri dhe etikë në kërkim”. Ky udhëzim (rregullore) u nxor nga Qeveria e Shqipërisë për të orientuar çështjet e lidhura me etikën për shoqëritë, institucionet dhe konsulentët që kryejnë punë kërkimore.
- Procedurat e UNICEF-it për Standardet Etike në Kërkim, Vlerësim, Mbledhje dhe Analizë të Dhënash (2021).

Ekipi i kërkimit respektoi standardet e mëposhtme themelore:

- se subjektet nuk vihen në rrezik të tepruar;
- pjesëmarrja është vullnetare, dhe subjektet informohen dhe u sigurohet një formë pëlqimi, me të cilën duhet të bien dakord paraprakisht; dhe
- ekzistojnë protokollet me shkrim për të siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, intervistuesit ndanë fletëpalosje me pjesëmarrësit në anketë dhe familjet e tyre, duke përfshirë informacion për shërbimet mbështetëse për kujdesin mendor dhe psikologjik, dhe kanalet e raportimit për trafikimin e qenieve njerëzore.

3.4 Kufizimet

Studimi aktual ka disa kufizime, sikurse paraqitet në vijim.

Ndjeshmëritë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe konceptet e termat shoqëruar.

Intervistuesit hasën raste ku, pasi personit i ishte shpjeguar tema e anketës, prindi ose kujdestari i së resë kundërshtoi pjesëmarrjen e vajzës në anketë. Ky hezitim erdhi për shkak se prindi ose kujdestari i konsideronte termat si ‘shfrytëzimi seksual’ të turpshëm dhe të pahijshëm për t’u diskutuar. Në këto raste, intervistuesi falënderoi personat dhe shkoi në shtëpinë e radhës.

Pandemia e COVID-19-ës

Mbledhja e të dhënave u krye nga data 14 janar deri më 1 mars 2022, kur rastet me COVID-19 ishin të shumta në Shqipëri, dhe intervistuesit hasën një sërë refuzimesh ndaj anketës për shkak të pandemisë. Disa persona kishin frikë të hapnin derën ose të nënshkruanin formularin e miratimit. Përpara daljes në terren, intervistuesit ishin trajnuar lidhur me masat shëndetësore dhe të sigurisë për COVID-19-ën, si dhe mbanin maska dhe ruanin distancën e sigurt ndërmjet tyre dhe pjesëtarëve të familjeve në çdo kohë. Megjithatë, pavarësisht këtyre masave të marra, pati refuzime ndaj anketës për shkak të frikës së personave se do të infekttoheshin nga virusi. Megjithëse pati refuzime, numri i parashikuar i anketave u arrit gjithsesi.

Mungesa e popullatës në moshë të re në zona të caktuara të studimit

Për shkak të disa vështirësive me gjetjen e të rinjve në zona rurale, ekipi i kërkimit u detyrua të riorganizonte dhe rishpërndante disa nga intervistat e planifikuara. Në përgjithësi, gjetja e të rinjve të

⁶ Shihni <https://www.healthmedialabirb.com/>

synuar për studimin nuk ishte e lehtë. Në disa pjesë të Kamzës (Tiranë), mungesa e të rinjve në komunitet ishte e theksuar. Në Kukës, Has dhe Tropojë, edhe ata pak të rinj që kishin mbetur, ishin jashtë shtëpisë duke punuar ose ishin në male me bagëtinë. Ku ishte e mundur, si në rastin e Tropojës, disa nga anketat e parashikuara për zonat rurale u zhvilluan në zona urbane.

Pyetjet orientuese

Megjithëse u bënë të gjitha përpjekjet për shmangien e pyetjeve orientuese drejtuar të rinjve të anketuar, në disa raste ishte e pashmangshme. Thjesht përmes hartimit të pyetjeve me disa alternativa, pyetjeve me shkallën e Likert-it dhe pyetjeve me përgjigje 'e vërtetë' ose 'e gabuar', alternativat e paraqitura për të rinjtë mund të kenë ndikuar përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve të tjera. Anketa u hartua për të testuar në mënyrë graduale njohuritë, ndaj, edhe nëse disa nga pyetjet ishin orientuese, të dhënat e mbledhura i mundësuan ekipit të kërkimit të merrte parasysh ndryshimet e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave ndërmjet dy anketave.

Mungesa e të dhënave cilësore

Anketa e valës së dytë ndoqi një qasje sasiore, prandaj, këtij raporti i mungojnë të dhëna cilësore domethënëse sa u përket njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Ky kufizim u kompensua disi nëpërmjet faktit që anketa e valës së dytë është rishikuar, pas rezultateve të anketës së valës së parë, për të thjeshtuar pyetjet, dhe janë shtuar pyetje dhe alternativa të tjera për të kuptuar më mirë aspekte të caktuara të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.

4. GJETJET: PJESA A

4.1 Profili i të rinjve të anketuar në të katërta qarqet

Nga 1,387 të rinj të anketuar në të katërta qarqet, 51 për qind ishin femra dhe 49 për qind ishin meshkuj (Figura 1). Shumica e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet (52%) ishin të moshës 18–24 vjeç, 20 për qind ishin 15–17 vjeç dhe 28 për qind ishin 25–29 vjeç (Figura 2).

Figura 1. Të anketuarit sipas seksit






Figura 2. Plotësuesit e anketës sipas grupmoshës.



Gjysma e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet jetonin në zona urbane dhe gjysma tjetër në zona rurale (Figura 3).

Figura 3. Plotësuesit e anketës sipas urbanitetit




4.2 Njohuritë rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore

Më pak të rinj të anketuar në të katërta qarqet dinin se trafikimi ndodh brenda Shqipërisë (40%) krahasuar me vendet e tjera (51%), dhe shumë më pak dinin se ndodhte dhe në komunitetin ose zonën e tyre (10%; Figura 4).

Figura 4. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë



Pyetja e anketës: Në dijeninë tuaj, në ç'masë ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (shtetasve shqiptarë) në vende të huaja, në Shqipëri dhe në komunitetin ose zonën tuaj? Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Te të rinjtë në të katërta qarqet, femrat kanë më shumë njohuri sesa meshkujt për vendet se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 5). Gjysma e femrave të anketuara kishin dijeni se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodhte edhe në Shqipëri, krahasuar me vetëm 30 për qind të meshkujve. Ndërkohë, 13 për qind e femrave kanë dijeni për ndodhshmërinë e trafikimit të qenieve njerëzore në komunitetin ose zonën e tyre, në krahasim me vetëm shtatë për qind të meshkujve.


Figura 5. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas seksit



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Të rinjtë e moshës 18-24 vjeç në të katërta qarqet kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë e tjerë lidhur me vendet se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 6), ku vetëm 43 për qind e grupmoshës 15-17 vjeç mendojnë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në masë të madhe ose shumë të madhe drejt vendeve të huaja, krahasuar me 55 për qind të grupmoshës 18-24 vjeç dhe 49 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç.


Figura 6. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Njohuria rreth trafikimit të qenieve njerëzore që ndodh në Shqipëri dhe në vendet e huaja është më e madhe te të rinjtë e anketuar në zonat urbane, me respektivisht 55 për qind dhe 47 për qind që mendojnë se ndodh në masë të madhe dhe shumë të madhe drejt vendeve të huaja (Figura 7).

Figura 7. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas urbanitetit.



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Format e shfrytëzimit të shqiptarëve në Shqipëri dhe jashtë vendit

Shfrytëzimi i shtetasve shqiptarë në Shqipëri

Të rinjtë e anketuar në katër qarqet kanë më shumë njohuri për lypjen e detyruar (93%) dhe shfrytëzimin seksual (87%) të fëmijëve në Shqipëri sesa për format e tjera të shfrytëzimit (Tabela 2), dhe femrat kanë më shumë njohuri sesa meshkujt. Për shembull, 92 për qind e femrave kanë njohuri për ndodhshmërinë e punës së detyruar të fëmijëve, krahasuar me 75 për qind të meshkujve. **Ndërkohë, grupmosha 18-24 vjeç ka më shumë njohuri sesa të rinjtë e tjerë lidhur me ndodhshmërinë e shumicës së formave të shfrytëzimit.** Për shembull, vetëm 90 për qind e grupmoshës 18-24 vjeç kanë njohuri për shfrytëzimin seksual të fëmijëve, krahasuar me 82 për qind të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 85 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç. **Të rinjtë e anketuar që jetojnë në zonat urbane të katër qarqeve kanë më shumë njohuri rreth shumicës së formave të shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri sesa të rinjtë që jetojnë në zona rurale.** Për shembull, 72 për qind e të rinjve në zona urbane kanë njohuri për ndodhshmërinë e lypjes së detyruar të të rriturve në Shqipëri, krahasuar me 61 për qind të të rinjve në zona rurale, dhe 88 për qind e të rinjve në zona urbane

kanë njohuri për ndodhshmërinë e kriminalitetit të detyruar të fëmijëve, krahasuar me 78 për qind të të rinjve në zona rurale.

Tabela 2. Njohuritë për format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri (%)

| Forma e shfrytëzimit | Totali, 4 qarqe | Seksi | | Grupmosha (vjeç) | | | Urbaniteti | |
|--|-----------------|------------|------------|------------------|------------|------------|------------|------------|
| | | F | M | 15-17 | 18-24 | 25-29 | Urban | Rural |
| shfrytëzimi seksual i të rriturve | 80 | 86 | 74 | 70 | 83 | 81 | 81 | 79 |
| shfrytëzimi seksual i fëmijëve | 87 | 93 | 81 | 82 | 90 | 85 | 87 | 87 |
| puna e detyruar e të rriturve | 70 | 74 | 66 | 62 | 71 | 73 | 68 | 71 |
| puna e detyruar e fëmijëve | 83 | 92 | 75 | 79 | 86 | 80 | 83 | 83 |
| martesa e detyruar | 67 | 75 | 59 | 59 | 67 | 72 | 70 | 64 |
| martesa e fëmijëve | 85 | 88 | 81 | 81 | 86 | 84 | 85 | 85 |
| lypja e detyruar e të rriturve | 66 | 71 | 62 | 55 | 67 | 73 | 72 | 61 |
| lypja e detyruar e fëmijëve | 93 | 97 | 88 | 90 | 93 | 93 | 94 | 91 |
| kriminaliteti i detyruar i të rriturve | 81 | 84 | 77 | 78 | 81 | 81 | 82 | 80 |
| kriminaliteti i detyruar i fëmijëve | 83 | 90 | 76 | 77 | 85 | 81 | 88 | 78 |
| N. | 1,387 | 704 | 683 | 275 | 728 | 384 | 691 | 696 |

Pyetja e anketës: Në dijeninë tuaj, a ndodhin format e mëposhtme të shfrytëzimit, që përfshijnë shtetasit shqiptarë, në Shqipëri? Tabela tregon përqindjet vetëm për alternativën e përgjigjes "po". **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Shfrytëzimi i shtetasve shqiptarë jashtë vendit

Të rinjtë e anketuar në katër qarqet kanë më shumë njohuri rreth kriminalitetit të detyruar të të rriturve (81%), kriminalitetit të detyruar të fëmijëve (76%), lypjes së detyruar të fëmijëve (76%) dhe shfrytëzimit seksual të të rriturve (76%) te shqiptarët e trafikuar jashtë vendit sesa për format e tjera të shfrytëzimit (Tabela 3). Ndër ta, femrat kishin më shumë njohuri sesa meshkujt lidhur me format e ndryshme të shfrytëzimit. Për shembull, 83 për qind e të rejave të anketuara kishin njohuri për ndodhshmërinë e shfrytëzimit seksual të fëmijëve, krahasuar me vetëm 64 për qind të të rinjve meshkuj. **Të rinjtë e moshës 18-24 vjeç kanë më shumë njohuri për format e ndryshme të shfrytëzimit sesa të rinjtë e tjerë.** Për shembull, 78 për qind e grupmoshës 18-24 vjeç kanë njohuri për shfrytëzimin seksual të fëmijëve, krahasuar me 69 për qind të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 67 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç. Në përgjithësi, **të rinjtë në zona urbane kanë më shumë njohuri sesa ata në zona rurale për format e shfrytëzimit që ndodhin jashtë vendit.** Për shembull, 64 për qind e të rinjve në zona urbane kanë njohuri për ndodhshmërinë e martesave të detyruara, krahasuar me vetëm 47 për qind të të rinjve në zona rurale.

Tabela 3. Njohuritë për format e shfrytëzimit që ndodhin jashtë vendit (%)

| Forma e shfrytëzimit | Totali, 4 qarqe | Seksi | | Grupmosha (vjeç) | | | Urbaniteti | |
|--|-----------------|------------|------------|------------------|------------|------------|------------|------------|
| | | F | M | 15-17 | 18-24 | 25-29 | Urban | Rural |
| shfrytëzimi seksual i të rriturve | 76 | 83 | 68 | 71 | 79 | 72 | 81 | 71 |
| shfrytëzimi seksual i fëmijëve | 73 | 83 | 64 | 69 | 78 | 67 | 76 | 71 |
| puna e detyruar e të rriturve | 67 | 69 | 64 | 68 | 66 | 68 | 69 | 65 |
| puna e detyruar e fëmijëve | 70 | 77 | 63 | 73 | 69 | 69 | 70 | 69 |
| martesa e detyruar | 56 | 59 | 52 | 55 | 56 | 55 | 64 | 47 |
| martesa e fëmijëve | 57 | 62 | 53 | 61 | 58 | 53 | 61 | 54 |
| lypja e detyruar e të rriturve | 56 | 60 | 53 | 53 | 57 | 58 | 61 | 52 |
| lypja e detyruar e fëmijëve | 76 | 81 | 70 | 77 | 77 | 72 | 79 | 72 |
| kriminaliteti i detyruar i të rriturve | 81 | 83 | 78 | 80 | 83 | 77 | 85 | 77 |
| kriminaliteti i detyruar i fëmijëve | 76 | 80 | 73 | 75 | 79 | 70 | 81 | 72 |
| N. | 1,387 | 704 | 683 | 275 | 728 | 384 | 691 | 696 |

Pyetja e anketës: Në dijeninë tuaj, a ndodhin format e mëposhtme të shfrytëzimit, që përfshijnë shtetasit shqiptarë, jashtë vendit? Tabela tregon përqindjet vetëm për alternativën e përgjigjes "po". **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Grupet në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore

Rezultatet e anketës tregojnë se ka një perceptim të anshëm gjinor të të rinjtë e anketuar në të katërta qarqet lidhur me grupet e personave në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Tabela 4). Grupi që konsiderojnë më në risk janë vajzat nën moshën 18 vjeç, me 77 për qind që e konsiderojnë këtë grup në risk të madh ose shumë të madh për t'u trafikuar. Ata mendojnë se grupi i dytë më në risk janë pakicat kombëtare, ku 47 për qind mendojnë se pakicat kombëtare kanë risk të madh ose shumë të madh për t'u trafikuar. **Vetëm pesë për qind e të rinjve në të katërta qarqet mendojnë se burrat kanë risk të lartë për t'u trafikuar.**


Tabela 4. Njohuri për grupet e popullsisë në rrezik për t'u trafikuar (%)

| Grupi i popullatës | Totali, 4 qarqe |
|----------------------------|-----------------|
| gra (18 dhe mbi 18 vjeç) | 37 |
| vajza (nën 18 vjeç) | 77 |
| burra (18 dhe mbi 18 vjeç) | 5 |
| djem (nën 18 vjeç) | 26 |
| pakicat kombëtare | 47 |
| persona nga zona rurale | 30 |
| N. | 1,387 |

Pyetja e anketës: Në dijeninë tuaj, në ç'masë mendoni se secili nga grupet e mëposhtme janë në risk të konsiderueshëm ose të lartë për t'u trafikuar? Tabela tregon përqindjet e të anketuarve lidhur me opinionin se grupe specifike janë "konsiderueshëm" ose "shumë" në rrezik për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Në të katërta qarqet, femrat kishin më shumë njohuri sesa meshkujt lidhur me grupet më në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 8). Për shembull, 88 për qind e femrave kishin njohuri që vajzat nën moshën 18 vjeç kanë risk të lartë ose shumë të lartë për t'u trafikuar, krahasuar me 66 për qind të meshkujve. Nuk kishte ndryshim ndërmjet femrave dhe meshkujve sa u përket përqindjeve lidhur me njohuritë rreth riskut të trafikimit të burrave dhe djemve.


Figura 8. Njohuri për grupet e popullsisë në rrezik për t'u trafikuar, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Të rinjtë e moshës 18-24 vjeç kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë e tjerë rreth grupeve të popullsisë që kanë risk për t'u trafikuar, përveç personave nga zonat rurale (Figura 9). Për shembull, 81 për qind e grupmoshës 18-24 vjeç mendojnë se vajzat nën moshën 18 vjeç kanë risk të lartë ose shumë të lartë për t'u trafikuar, krahasuar me 66 për qind të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 75 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç.


Figura 9. Njohuri për grupet e popullsisë në rrezik për t'u trafikuar, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Të rinjtë e anketuar në zonat urbane në të katërta qarqet kanë më shumë njohuri sesa ata në zonat rurale sa i përket faktit se personat nga zonat rurale kanë risk të konsiderueshëm ose shumë të madh për t'u trafikuar (Figura 10).

Figura 10. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk “të konsiderueshëm” ose “të lartë” për t'u trafikuar. Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

Metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore

Me qëllim vlerësimin e njohurive të të rinjve të anketuar në katër qarqet sa u përket metodave të rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore, të rinjtë u pyetën nëse ishin dakord me disa pohime lidhur me metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore. Rezultatet (Tabela 5) tregojnë se të rinjtë kanë njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, megjithëse **relativisht pak prej tyre (48%) dinin se familjarët mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore.**


Tabela 5. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore

| Metoda e rekrutimit | Totali, 4 qarqe |
|--|-----------------|
| Trafikantët janë pjesë e rrjeteve të organizuara kriminale | 90 |
| Për të rekrutuar viktimë mund të përdoret interneti | 94 |
| Trafikantët të qenieve njerëzore mund të jenë miqtë | 86 |
| Trafikantët të qenieve njerëzore mund të jenë familjarët | 48 |
| Trafikant i qenieve njerëzore mund të jetë i dashuri ose e dashura | 85 |
| N. | 1,387 |

Pyetja e anketës: Në ç'masë bini ose nuk bini dakord me pohimet e mëposhtme? Tabela tregon përqindjet e të anketuarve që bien plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Në grupin e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet, femrat kanë më shumë njohuri sesa meshkujt rreth metodave të rekrutimit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikantëve të qenieve njerëzore (Figura 11). Për shembull, 52 për qind e femrave dinin se trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë familjarët, krahasuar me 45 për qind të meshkujve dhe, respektivisht, 90 për qind dhe 81 për qind, kishin njohuri se trafikantë mund të jetë i dashuri ose e dashura.

Figura 11. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas seksit




Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve që bien plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Diferenca në njohuritë e grupmohave të ndryshme lidhur me metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore nuk është e konsiderueshme.

Diferenca ndërmjet njohurive të të rinjve në zona urbane dhe atyre në zona rurale sa u përket metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore ishte e vogël (Figura 12), megjithëse më pak **të rinj në zona urbane (41%) sesa ata në zona rurale (56%) dinin se familjarët mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore.**

Figura 12. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas urbanitetit




Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve që bien plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore

Përgjithësisht, të rinjtë në të katërta qarqet dinë se mund t'i raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore në rajonin e policisë (85%) dhe në linjën telefonike të policisë 129 (75%), por kishin më pak njohuri rreth kanaleve të tjera të raportimit (Figura 13). Vetëm dy për qind e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet nuk kanë njohuri rreth asnjë kanali raportimi.

Figura 13. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetja e anketës: Në ditjeninë tuaj, cila nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar të trafikimit të qenieve njerëzore? Disa. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Në grupin e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet, femrat njihnin më shumë mënyra raportimi të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore sesa meshkujt (Tabela 6). Për shembull, 41 për qind e femrave dinë se mund t'ua raportojnë një rast të dyshuar mësuesve, psikologëve ose profesionistëve të tjerë në shkollë, krahasuar me 32 për qind të meshkujve.

Diferenca ndërmjet nivelit të njohurive të grupmohave të ndryshme lidhur me mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore është e vogël, përveç raportimit të mësuesit, psikologët ose profesionistët e tjerë në shkollë (49% e grupmohës 15–17 vjeç, 35% e grupmohës 18–24 vjeç dhe 30% e grupmohës 25–29 vjeç).

Të rinjtë në zona urbane njohin më shumë mënyra sesa të rinjtë në zona rurale (83% dhe 68% përkatësisht) për të raportuar një rast të dyshuar trafikimi të qenieve njerëzore, veçanërisht sa i përket raportimit në linjën telefonike të policisë 129.

Tabela 6. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit (%)

| Ku të raportoni raste të trafikimit | Seksi | | Grupmosha (vjeç) | | | Urbaniteti | |
|--|------------|------------|------------------|------------|------------|------------|------------|
| | F | M | 15-17 | 18-24 | 25-29 | Urban | Rural |
| rajoni i policisë | 88 | 83 | 85 | 85 | 85 | 88 | 83 |
| linja telefonike e policisë 129 | 75 | 76 | 75 | 74 | 78 | 83 | 68 |
| mësues, psikolog, profesionist tjetër në shkollë | 41 | 32 | 49 | 35 | 30 | 41 | 32 |
| punonjës për mbrojtjen e fëmijës | 22 | 14 | 18 | 19 | 13 | 19 | 16 |
| organizatë jofitimprurëse | 18 | 15 | 10 | 18 | 18 | 17 | 16 |
| mjek ose infermier | 13 | 13 | 15 | 12 | 14 | 11 | 15 |
| linja kombëtare për këshillimin e fëmijëve ALO 116 | 14 | 9 | 12 | 12 | 9 | 14 | 9 |
| linja telefonike kombëtare (116 006) | 13 | 7 | 11 | 10 | 9 | 11 | 9 |
| aplikacion telefonik ('Telefono, Raporto!') | 10 | 5 | 6 | 7 | 8 | 10 | 5 |
| profesionist tjetër në bashki ose njësinë administrative përkatëse | 8 | 5 | 5 | 7 | 8 | 10 | 3 |
| nuk pranoj të përgjigjem | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| tjetër | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| asnjëra nga alternativat e mësipërme | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 1 | 3 |
| N. | 704 | 683 | 275 | 728 | 384 | 691 | 696 |

Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

Raportimi ballë për ballë tek institucionet ligjzbatuese është mënyra e parapëlqyer e raportimit të një rasti të dyshuar trafikimi të qenieve njerëzore për të rinjtë në të katërta qarqet, ku 72 për qind parapëlqejnë këtë metodë raportimi, duke vijuar me 36 për qind për raportimin përmes shërbimeve telefonike (Tab 7).

Femrat në të katërta qarqet parapëlqejnë më shumë sesa meshkujt të gjitha mënyrat e raportimit të një rasti të dyshuar trafikimi të qenieve njerëzore, me vetëm dy për qind që nuk parapëlqejnë asnjë kanal, krahasuar me shtatë për qind të të rinjve meshkuj. Diferenca ndërmjet pëlqimit të grupmoshave të ndryshme lidhur me kanalin e parapëlqyer të raportimit të një rasti trafikimi të qenieve njerëzore është e vogël, ku grupmosha 15-17 vjeç ka më pak gjasë ta raportojë rastin te një OJF e specializuar. **Ndërkohë, shtatë për qind e grupmoshës 25-29 vjeç nuk parapëlqen asnjë nga kanalet e raportimit të renditura, krahasuar me tre për qind të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 18-24 vjeç.**

Më tej, të rinjtë në zona rurale kanë një parapëlqim më të madh sesa të rinjtë në zona urbane (respektivisht 79% dhe 65%) për ta raportuar një rast të dyshuar trafikimi të qenieve njerëzore ballë për ballë në polici ose prokurori.

Tabela 7. Kanalet e parapëlqyera të raportimit të një rasti të dyshuar të trafikimit të qenieve njerëzore (%)


| Mënyrat e raportimit të rastit të trafikimit | Totali, 4 qarqe | Seksi | | Grupmosha (vjeç) | | | Urbaniteti | |
|--|-----------------|------------|------------|------------------|------------|------------|------------|------------|
| | | F | M | 15-17 | 18-24 | 25-29 | Urban | Rural |
| ballë për ballë tek institucionet ligjzbatuese (polici, prokurori) | 72 | 75 | 69 | 68 | 74 | 71 | 65 | 79 |
| shërbimet telefonike (linjat e këshillimit, linjat e ndihmës) | 36 | 36 | 36 | 36 | 36 | 34 | 34 | 38 |
| raportimi ballëpërballë tek institucionet joligjzbatuese | 24 | 27 | 21 | 28 | 24 | 21 | 21 | 26 |
| OJF e specializuar për çështjen | 12 | 13 | 11 | 6 | 13 | 14 | 9 | 15 |
| platformë në internet, aplikacion telefoni | 9 | 11 | 7 | 8 | 9 | 9 | 10 | 7 |
| asnjëra nga alternativat e mësipërme | 4 | 2 | 7 | 3 | 3 | 7 | 5 | 4 |
| nuk e di | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| N. | 1,387 | 704 | 683 | 275 | 728 | 384 | 691 | 696 |

Pyetja e anketës: Te cila nga kanalet e mëposhtme të raportimit të një rasti të trafikimit të qenieve njerëzore do të merrnit në konsideratë ose do të parapëlqenit të raportoni? Disa. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Në grupin e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet, forma më e njohur e mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri (Figura 14) është mbështetja e posaçme nga policia e shtetit (45%), e ndjekur nga mbështetja psikosociale (28%), ndërsa **27 për qind e të rinjve nuk kishin asnjë njohuri për këto forma mbështetjeje.**

Figura 14. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri



Pyetja e anketës: Në dijeninë tuaj, cilat nga llojet e mëposhtme të mbështetjes janë të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri? Disa. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Në të katërta qarqet, të rejtat kishin më shumë njohuri sesa të rinjtë meshkuj për format e mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 8), veçanërisht sa i përket mbështetjes psikosociale (37% e femrave dhe 20% e meshkujve). **Vetëm 21 për qind e femrave nuk kanë asnjë njohuri rreth mbështetjejeve të tilla, krahasuar me 34 për qind të meshkujve.** Diferencat ndërmjet grupmoshave të ndryshme lidhur me mbështetjen për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë të vogla, ku 30 për qind e grupmoshës 15-17 vjeç dhe 25-29 vjeç nuk kanë dijeni për këto mbështetje, krahasuar me 26 për qind të grupmoshës 18-24 vjeç. Këto diferenca të vogla janë të pranishme edhe ndërmjet të rinjve në zonat urbane dhe rurale, përkatësisht 32 dhe 24 për qind, **që nuk kanë dijeni për asnjë formë mbështetjeje të disponueshme për viktimat në Shqipëri.**

Tabela 8. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit (%)

| Lloji i mbështetjes për viktimat | Seksi | | Grupmosha (vjeç) | | | Urbaniteti | |
|--|------------|------------|------------------|------------|------------|------------|------------|
| | F | M | 15-17 | 18-24 | 25-29 | Urban | Rural |
| mbështetje e posaçme nga policia e shtetit | 46 | 44 | 53 | 46 | 37 | 42 | 47 |
| mbështetje psikosociale (shëndeti mendor) | 37 | 20 | 23 | 31 | 25 | 27 | 30 |
| mbështetje sociale (edhe mbështetjen për riintegrim) nga qeveria | 27 | 25 | 29 | 24 | 30 | 26 | 26 |
| mbështetje sociale (edhe mbështetjen për riintegrim) nga OJF-të | 21 | 19 | 16 | 19 | 23 | 20 | 20 |
| mbështetje për strehim | 21 | 16 | 16 | 22 | 13 | 19 | 18 |
| Këshillim përmes linjave telefonike të këshillimit ose ndihmës | 21 | 14 | 22 | 16 | 19 | 17 | 18 |
| akomodim në streha | 20 | 14 | 17 | 16 | 18 | 20 | 14 |
| mbështetje financiare | 17 | 15 | 20 | 15 | 15 | 17 | 15 |
| mbështetje për punësim | 14 | 12 | 14 | 14 | 11 | 13 | 13 |
| mbështetje mjekësore | 15 | 10 | 11 | 13 | 11 | 10 | 14 |
| këshillim për të drejtat ligjore dhe shërbimet e disponueshme | 12 | 10 | 16 | 9 | 12 | 12 | 10 |
| mbështetje e posaçme për trajnim ose arsimim | 7 | 4 | 5 | 6 | 5 | 5 | 6 |
| nuk e dinte ose nuk u përgjigj | 21 | 34 | 30 | 26 | 30 | 32 | 24 |
| N | 704 | 683 | 275 | 728 | 384 | 691 | 696 |

Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.


4.3 Qëndrimet lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Nivelet e shqetësimit

Shqetësimi lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri është i lartë te të rinjtë e anketuar në katër qarqet, ku më shumë se dy të tretat (69%) janë jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar nga ky fenomen.

Ndryshimi ndërmjet të rinjve meshkuj dhe femra lidhur me nivelin e shqetësimit për trafikimin e qenieve njerëzore është i madh, ku 83 për qind e femrave ndihen jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar për të, krahasuar me vetëm 57 për qind të meshkujve (Figura 15).


Figura 15. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Në të katërta qarqet, të rinjtë e moshës 15-17 vjeç janë më pak të shqetësuar nga fenomeni sesa grupmoshat e tjera (57% e grupmoshës 15-17 vjeç, 74% e grupmoshës 18-24 vjeç dhe 69% e grupmoshës 25-29 vjeç janë jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar nga trafikimi; Figura 16).


Figura 126. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Të rinjtë në zona urbane janë më të shqetësuar sesa të rinjtë në zona rurale për trafikimin e qenieve njerëzore (76% dhe 63%, respektivisht; Figura 17).

Figura 137. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Në të katërta qarqet, të rinjtë raportuan se janë më shumë të shqetësuar për mungesën e zbatimit të ligjit (72%) dhe për rritjen e trafikimit të fëmijëve ose të rinjve (63%), ku femrat janë më të shqetësuar sesa meshkujt për shumicën e aspekteve të trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 9). Të rinjtë në moshë më të madhe shprehin më shumë shqetësim për disa nga fushat sesa të rinjtë e tjerë, dhe të rinjtë në zona urbane janë më të shqetësuar sesa ata në zona rurale për këtë fenomen.

Tabela 9. Fushat më kryesore të shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit (%)

| Fusha e shqetësimit | Totali, 4 qarqe | Seksi | | Grupmosha (vjeç) | | | Urbaniteti | |
|---|-----------------|------------|------------|------------------|------------|------------|------------|------------|
| | | F | M | 15–17 | 18–24 | 25–29 | Urban | Rural |
| mungesa e zbatimit të ligjit | 72 | 72 | 71 | 73 | 69 | 76 | 73 | 70 |
| rritja e trafikimit të fëmijëve dhe të rinjve | 63 | 69 | 57 | 68 | 62 | 61 | 64 | 61 |
| rritja e trafikimit të të rriturve | 28 | 29 | 27 | 30 | 25 | 34 | 32 | 24 |
| besueshmëria e ulët e institucioneve përkatëse ku raportohen raste të tilla | 41 | 41 | 41 | 37 | 38 | 51 | 46 | 36 |
| niveli i ulët i ndërgjegjësimit të popullatës lidhur me këtë fenomen | 47 | 48 | 45 | 37 | 47 | 52 | 52 | 41 |
| mbështetja e pamjaftueshme për viktimat | 34 | 36 | 33 | 33 | 32 | 41 | 38 | 30 |
| lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore | 28 | 28 | 28 | 33 | 25 | 32 | 30 | 26 |
| lidhja ndërmjet migracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore | 17 | 19 | 16 | 15 | 16 | 21 | 18 | 17 |
| tjetër | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| N. | 1,387 | 704 | 683 | 275 | 728 | 384 | 691 | 696 |

Pyetja e anketës: Çfarë ju shqetëson më shumë? Disa. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Qëndrimet ndaj viktimave

Thuajse të gjithë (90%) të rinjtë në të katërta qarqet besojnë fuqishëm se viktimat e trafikimit duhet të marrin mbështetje.

Të rejtat kanë më shumë empati sesa të rinjtë meshkuj ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 10), përkatësisht me 96 për qind dhe 85 për qind, që bien dakord (jashtëzakonisht ose shumë) për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave dhe personave në risk për t'u trafikuar.

Të rinjtë e moshës 18-24 vjeç janë më empatikë sesa të rinjtë e tjerë ndaj viktimave, megjithëse ndryshimet janë të vogla.

Empatia ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në zonat rurale të të katërta qarqeve është më e ulët sesa në zonat urbane. Nëntëdhjetë e pesë për qind e të rinjve në zona urbane dhe 86 për qind e të rinjve në zona rurale bien dakord (jashtëzakonisht ose shumë) me ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave dhe personave në risk për t'u trafikuar.

Tabela 10. Niveli i dakordimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar, sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit (%)

| Niveli i dakordimit | Seksi | | Grupmosha (vjeç) | | | Urbaniteti | |
|---------------------------|------------|------------|------------------|------------|------------|------------|------------|
| | F | M | 15–17 | 18–24 | 25–29 | Urban | Rural |
| jashtëzakonisht ose shumë | 96 | 85 | 86 | 91 | 90 | 95 | 86 |
| disi | 4 | 11 | 8 | 7 | 7 | 4 | 11 |
| pak ose aspak | 0 | 2 | 3 | 1 | 1 | 0 | 2 |
| nd ose np | 0 | 2 | 3 | 0 | 1 | 0 | 2 |
| N. | 704 | 683 | 275 | 728 | 384 | 691 | 696 |


Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe; nd - nuk e di; np - nuk u përgjigji.

4.4 Praktikrat lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë në të katërta qarqet e anketuara janë më të interesuar për të mësuar se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje (43%), dhe më pak të interesuar për të mësuar rreth formave të ndryshme të shfrytëzimit (28%; Figura 18).


Figura 18. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetja e anketës: Deri në cilën masë jeni i/e interesuar për të mësuar rreth këtyre aktiviteteve? **Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Të rejtat në të katërta qarqet janë shumë më të interesuara sesa të rinjtë meshkuj për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 19), veçanërisht lidhur me mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit (52% dhe 27% përkatësisht), dhe se ku mund të drejtohen viktimat për të marrë ndihmë ose mbështetje (55% dhe 30% përkatësisht).

Figura 19.14. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

Të rinjtë në moshë më të madhe (25-29 vjeç) janë më pak të interesuar për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me grupmoshat e tjera, veçanërisht lidhur me institucionet ku viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore mund të drejtohen për të marrë ndihmë ose mbështetje (Tabela 11).


Tabela 11. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

| Çështje e trafikimit të qenieve njerëzore | Grupmosha (vjeç) | | |
|--|------------------|------------|------------|
| | 15-17 | 18-24 | 25-29 |
| Kush është i rrezikuar për t'u trafikuar | 35 | 38 | 31 |
| Format e ndryshme të shfrytëzimit | 35 | 29 | 23 |
| Kush mund të jetë trafikant ose profili i trafikantëve | 41 | 40 | 31 |
| Metodat ose taktikat e rekrutimit të viktimave | 35 | 37 | 29 |
| Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore | 37 | 42 | 35 |
| Ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje | 42 | 47 | 34 |
| N. | 275 | 728 | 384 |

Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

Të rinjtë e anketuar në zonat urbane janë më shumë të interesuar të mësojnë rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sesa të rinjtë në zonat rurale (Figura 20). Për shembull, 48 për qind e të rinjve në zonat urbane janë të interesuar të mësojnë se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje, krahasuar me 37 për qind të të rinjve në zonat rurale.

Figura 150. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Interesi për t'u përfshirë në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore

Të rinjtë në të katërta qarqet janë më të interesuar për të informuar familjarët dhe miqtë e tyre rreth çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore (61%; Tabela 12), dhe më pak të interesuar për vullnetarizmin në punën kundër trafikimit të një OJF-je (39%) ose për të mbështetur mbledhjen e fondeve për programet kundër trafikimit (40%).


Tabela 12. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore (%)

| Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes kundër trafikimit të qenieve njerëzore | Totali, 4 qarqe |
|---|-----------------|
| Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit | 59 |
| Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet | 55 |
| Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore | 61 |
| Vullnetarizmi në punën kundër trafikimit të një OJF-je | 39 |
| Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit | 40 |
| Raportimi për një viktimit të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore | 59 |
| Raportimi për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore | 57 |
| N. | 1,387 |

Pyetja e anketës: Sa i/e interesuar do të ishit për t'u përfshirë në aktivitetet e mëposhtme? Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Në grupin e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet, femrat janë shumë më të interesuara për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes kundër trafikimit të qenieve njerëzore sesa meshkujt (Figura 21). Kjo diferencë është me e theksuar sa i përket përfshirjes në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose në komunitet (respektivisht 69% dhe 41%).

Figura 21. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Sa u përket të gjitha aktiviteteve të parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave, grupmosha 18-24 vjeç është më e interesuar sesa grupmoshat e tjera (Tabela 13). Kjo diferencë në interes është më e theksuar sa i përket raportimit për një viktimë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore.


Tabela 13. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

| Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes kundër trafikimit të qenieve njerëzore | Grupmosha (vjeç) | | |
|---|------------------|------------|------------|
| | 15-17 | 18-24 | 25-29 |
| Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit | 51 | 64 | 52 |
| Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet | 51 | 59 | 48 |
| Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore | 56 | 65 | 57 |
| Vullnetarizmi në punën kundër trafikimit të një OJF-je | 41 | 43 | 31 |
| Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit | 42 | 43 | 34 |
| Raportimi për një viktimë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore | 47 | 67 | 51 |
| Raportimi për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore | 46 | 63 | 51 |
| N. | 275 | 728 | 384 |

Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.

Të rinjtë në zonat urbane të të katërta qarqeve janë më të interesuar sesa të rinjtë në zonat rurale për t'u përfshirë në aktivitetet kundër trafikimit të qenieve njerëzore të renditura në vijim (Figura 22). Për shembull, 65 për qind e të rinjve në zonat urbane janë shumë ose disi të interesuar për të informuar familjarët ose miqtë e tyre rreth çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me 58 për qind të të rinjve në zonat rurale.

Figura 162. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Totali, 4 qarqe.


5. GJETJET: PJESA B

Ky seksion i raportit trajton ekspozimin e të rinjve të anketuar ndaj komunikimeve të UNICEF-it dhe treguesit që paraqesin ndryshime pozitive të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave (synimi për t'u përfshirë) të të rinjve në të katërta qarqet që nga anketa e valës së parë dhe pas shpërndarjes së materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore.

5.1 Ekspozimi ndaj komunikimeve të UNICEF-it

Thuajse 26 për qind e të rinjve të anketuar në të katërta qarqet raportojnë se janë ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit (Figura 23).⁷ Nga këta të rinj, 56 për qind ishin ekspozuar ndaj materialeve përmes televizionit, 47 për qind përmes Instagram-it, 47 për qind përmes diskutimeve në shkollë, 29 për qind përmes Facebook-ut dhe 23 për qind përmes broshurave ose materialeve të shtypura.


Figura 23. Kanalet e ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore



Pyetja e anketës: Përmes cilit kanal komunikimi të mëposhtëm u informuat për ngjarjet, mesazhet ose materialet e komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore? Disa. **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Totali, 4 qarqe.

Nga të rinjtë që ishin ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore në dy vitet e fundit, **97 për qind raportuan se njohuritë e tyre për trafikimin e qenieve njerëzore janë shtuar si rezultat i ekspozimit** (10% në masë shumë të madhe, 61% në masë të madhe dhe 26% në një farë mase; Figura 24).

Figura 174. Masa e përmirësimit të njohurive për trafikimin e qenieve njerëzore pas ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit




Pyetja e anketës: Deri në ç'masë është përmirësuar niveli juaj i njohurive rreth trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Totali, 4 qarqe.

Për më tepër, 96 për qind e të rinjve të ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore në dy vitet e fundit deklaruan se qëndrimet e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore kanë ndryshuar dhe se tani janë të interesuar të luajnë një rol më aktiv në luftën

⁷ Referuar punimit të realizuar nga UNICEF në Shqipëri dhe partnerët e tij nga muaji prill 2020 deri në periudhën e anketimit, në kuadër të Programit "Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria".

kundër këtij fenomeni (11% në nivel shumë të lartë, 54% në nivel të lartë dhe 31% disi të interesuar; Figura 25).

Figura 25. Masa e ndryshimit të qëndrimeve pas ekspozimit ndaj materialeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore




Pyetja e anketës: Deri në ç'masë ka ndryshuar qëndrimi juaj lidhur me përfshirjen më aktive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Totali, 4 qarqe.

5.2 Ndryshimet e raportuara të njohurive

Njohuri për të paktën tri mënyra për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore

Rezultatet nga anketat e valës së parë dhe të dytë paraqesin nivele shumë të ngjashme njohurish të të rinjtë e anketuar në të katërta qarqet lidhur me të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore (48% dhe 49% përkatësisht; Figura 26).


Figura 186. Përqindja e të rinjve të anketuar që njohin të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore; vala e parë dhe e dytë



Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe

Në anketën e dytë, 61 për qind e të rinjve në të katërta qarqet, që janë ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore në dy vitet e fundit, deklaruan se njohin të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 42 për qind të të rinjve të anketuar që nuk janë ekspozuar ndaj këtyre materialeve (Figura 27). Këto rezultate tregojnë se ekspozimi ndaj materialeve ka përmirësuar njohuritë lidhur me raportimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Figura 2719. Përqindja e të rinjve të anketuar që njohin të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore; ata të ekspozuar dhe të paekspozuar ndaj materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; vala e dytë




Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe

Njohja e të paktën tri llojeve të mbështetjes për viktimat e trafikimit

Rezultatet e anketës së dytë tregojnë një rritje të nivelit të njohurive rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit, ku 39 për qind e të rinjve në valën e dytë dhe 27 për qind e të rinjve në valën e parë njohin të paktën tri lloje mbështetjeje të tillë në Shqipëri (Figura 28).


Figura 28. Përqindja e të rinjve të anketuar që njohin të paktën tri lloje mbështetjeje për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; vala e parë dhe e dytë



Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe

Ndikimi pozitiv i ekspozimit ndaj materialeve të trafikimit të qenieve njerëzore të rritja e njohurive rreth trafikimit të qenieve njerëzore është konfirmuar nga rezultatet e anketës së valës së dytë, ku 51 për qind e të rinjve të ekspozuar ndaj materialeve njihnin të paktën tri lloje mbështetjeje për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri (Figura 29), krahasuar me 35 për qind që nuk janë ekspozuar.

Figura 29. Përqindja e të rinjve që njohin të paktën tri lloje mbështetjeje për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; vala e parë dhe e dytë




Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

5.3 Ndryshimet e raportuara të qëndrimeve

Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Niveli i shqetësimit për trafikimin e qenieve njerëzore të të rinjtë e anketuar në të katërta qarqet duket se është rritur në anketën e valës së dytë krahasuar me atë të valës së parë (Figura 30). Rezultatet nga anketa e valës së dytë tregojnë se rreth 69 për qind e të rinjve të anketuar janë jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore, krahasuar me 56 për qind të të rinjve të anketuar në valën e parë.

Figura 30. Përqindja e të rinjve të anketuar që janë jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore; vala e parë dhe e dytë




Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

5.4 Ndryshimet e raportuara të përfshirjes ose praktikave

Interesi për t'u përfshirë në të paktën tri aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë në të katërta qarqet raportuan interes më të madh për t'u përfshirë në aktivitetet kundër trafikimit të qenieve njerëzore në anketën e valës së dytë sesa në të parën (respektivisht 61% dhe 57% ishin shumë ose disi të interesuar për t'u përfshirë në të paktën tri aktivitete të tilla; Figura 31). Megjithatë, duhet të tregohet kujdes gjatë marrjes parasysh të këtyre shifrave, pasi listat e aktiviteteve në të dyja anketat nuk ishin saktësisht të njëjta (vala e parë përfshinte aktivitete si parja e një filmi ose leximi i një libri për trafikimin e qenieve njerëzore, ndërsa vala e dytë përfshinte aktivitete si raportimi i një viktime ose rasti të dyshuar trafikimi dhe masa të tjera më aktive).


Figura 201. Përqindja e të rinjve të anketuar që janë shumë ose disi të interesuar për t'u përfshirë në të paktën tri aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore; vala e parë dhe e dytë



Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

Efektet e materialeve/mesazheve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore duket se kanë pasur ndikim pozitiv në motivimin e të rinjve për t'u përfshirë në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 32). Rreth tetë nga dhjetë të rinj të anketuar (78%) që ishin ekspozuar ndaj materialeve raportuan se ishin të interesuar për t'u përfshirë në të paktën tri aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm gjysmën (51%) e të paekspozuarve.

Figura 32. Përqindja e të rinjve të anketuar të interesuar për të paktën tri aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore; të ekspozuarit dhe të paekspozuarit ndaj materialeve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; vala e dytë



Popullata e synuar: Totali, 4 qarqe.

6. PËRFUNDIME

Ky raport, që paraqet gjetjet kryesore nga anketa e valës së dytë, dhe bën disa krahasime me të dhënat nga anketa e valës së parë, mundëson pikëpamje të vlefshme rreth njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve të anketuar në të katërta qarqet e Shqipërisë (të përmbledhura për Dibërën, Kukësin, Shkodrën dhe Tiranën) lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Këto gjetje do t'u shërbejnë subjekteve të përfshira në aktivitetet kundër trafikimit në fushat e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave.

Të dhënat e anketës, të raportuara në Pjesën A, tregojnë se, në vitin 2022, femrat kanë më shumë njohuri dhe një qëndrim më të kuptueshëm sesa meshkujt lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, dhe interes më të lartë për t'u përfshirë në aktivitete kundër trafikimit. Femrat e anketuara në të katërta qarqet kanë më shumë njohuri sesa meshkujt lidhur me vendet se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore, format e ndryshme të shfrytëzimit që mund të ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit, personat në risk për t'u trafikuar, metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore, mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat. Gjithashtu, femrat janë më të shqetësuara sesa meshkujt e anketuar lidhur me fenomenin, si dhe janë më empatike ndaj viktimave dhe më dakord me ofrimin e mbështetjes ndaj tyre. Krahas kësaj, femrat janë më të interesuara sesa meshkujt për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore. Këto rezultate sugjerojnë se programet e ardhshme në Shqipëri duhet të synojnë të rinjtë meshkuj, me qëllim përmirësimin e njohurive të tyre dhe ndryshimin e qëndrimeve ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe për të rritur interesin e tyre për të mësuar më shumë rreth fenomenit dhe për t'u përfshirë në aktivitete kundër trafikimit.

Rezultatet tregojnë se, në vitin 2022, të rinjtë e moshës 18-24 vjeç kanë më shumë njohuri dhe një qëndrim më mirëkuptues ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe interes më të lartë për t'u përfshirë në aktivitete kundër trafikimit sesa kanë grupmoshat e tjera. Për shembull, grupmosha 18-24 vjeç ka më shumë njohuri rreth vendeve ku ndodh trafikimi, formave të shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit, si dhe rreth personave në risk. Gjithashtu, ata kanë më shumë empati ndaj viktimave dhe janë më shumë dakord sesa grupmoshat e tjera me ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave, si dhe janë më të interesuar për t'u përfshirë në aktivitete të parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore. Megjithatë, duhet theksuar se diferenca ndërmjet grupmoshave sa u përket disa treguesve është e vogël. Për shembull, nuk ka diferencë të konsiderueshme sa u përket niveleve të njohurive rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara dhe shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat. Këto gjetje sugjerojnë se, megjithëse programet e ardhshme për përmirësimin e njohurive dhe qëndrimeve të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe rritjen e interesit të tyre për të mësuar më shumë rreth fenomenit dhe për t'u përfshirë në aktivitete kundër trafikimit duhet të synojnë grupmoshën më të vogël (15-17 vjeç) dhe grupmoshën më të madhe (25-29 vjeç), programet duhet të fokusohen edhe te grupmosha 18-24 vjeç.

Anketa konstatoi diferenca të vogla ndërmjet të rinjve në zona urbane dhe atyre në zona rurale sa u përket njohurive dhe qëndrimeve ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe interesit për të mësuar më shumë rreth fenomenit dhe për t'u përfshirë në aktivitete kundër trafikimit. Për shembull, të rinjtë në zona urbane kanë më tepër njohuri sesa të rinjtë në zona rurale se ku ndodh trafikimi, rreth formave të shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit, dhe mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, qëndrimet e të rinjve në zona urbane janë më empatike sesa qëndrimet e të rinjve në zona rurale. Për shembull, shqetësimi për trafikimin e qenieve njerëzore është më i madh te të rinjtë në zona urbane, të cilët janë edhe më empatikë për viktimat dhe janë më shumë dakord me ofrimin e mbështetjes ndaj tyre. Po ashtu, edhe interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes është më i madh te të rinjtë në zona urbane. Ndryshimi në nivelin e njohurive të të rinjve do të thotë se nuk mund të bëhen komente përfundimtare lidhur me faktin nëse të rinjtë në zona urbane apo ata në zona rurale kanë nivele më të larta njohurish për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore, si dhe për shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat në Shqipëri. Gjithsesi, megjithëse programet e ardhshme për përmirësimin e njohurive dhe qëndrimeve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe rritjen e interesit për të mësuar më shumë rreth fenomenit dhe për t'u përfshirë në

aktivitete kundër trafikimit duhet të synojnë të rinjtë në zona urbane dhe rurale, ato duhet të fokusohen më shumë te të rinjtë në zonat rurale të vendit.

Të dhënat e anketës, të raportuara në Pjesën B, vënë në dukje ndryshimet e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave që prej anketës së parë. Seksioni thekson se më shumë të rinj të ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit në dy vitet e fundit deklaruan se njohin të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me ata të paekspozuar ndaj materialeve. Për më tepër, në valën e dytë vërehet një rritje në nivelin e njohurive të të rinjve sa i përket mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit në krahasim me valën e parë (respektivisht 39% dhe 27%, që njohin të paktën tri lloje mbështetjeje në vend).

Ndërkohë, nivelet e shqetësimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore janë rritur midis dy anketave (nga 56% në anketën e parë në thujse 70% në anketën e dytë). Gjithashtu, më shumë të rinj raportuan se janë të interesuar për t'u përfshirë në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore në anketën e valës së dytë sesa në atë të valës së parë, dhe materialet e komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore duket se kanë pasur ndikim në këtë ndryshim, duke i motivuar të rinjtë të luajnë një rol më aktiv në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Rreth tetë nga dhjetë të rinj të anketuar, që ishin ekspozuar ndaj materialeve, raportuan se ishin të interesuar për t'u përfshirë në të paktën tri aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm gjysmën e të paekspozuarve ndaj materialeve.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se subjektet e përfshira në luftën kundër trafikimit duhet t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre te përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore te të rinjtë meshkuj e të gjitha grupmoshave, si dhe te të rinjtë në zonat rurale të të katërta qarqeve. Duhet t'i kushtohet vëmendje përmirësimit të njohurive për praninë e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe në zonën ose komunitetin vendas; faktit se djemtë, burrat dhe të rinjtë në zona rurale janë në risk për t'u trafikuar; se pjesëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore; duke theksuar mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore te subjekte të tjera veç policisë; dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Programet parandaluese mund të synojnë gjithashtu përmirësimin e qëndrimeve të të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, ndërsa programet e ardhshme edukative mund të përdorin metoda komunikimi të njohura nga të rinjtë e anketuar në të katërta qarqet: përkatësisht mediat sociale, televizionin, bisedat në shkollë dhe materialet e shtypura.

Së fundi, studimet e ardhshme do të kontribuojnë në bazat e njohurisë rreth njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Këto studime mund të përdorin qasje metodash të kombinuara, me qëllim mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore nga të rinjtë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e tyre lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Këto studime mund të trajtojnë edhe qarqe ose bashki të tjera krahas atyre të përfshira në raportin aktual. Gjithashtu, mund të shfrytëzojnë metoda efikase kërkimi dhe vlerësimi për të analizuar ndikimet e fushatave të komunikimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore te të rinjtë shqiptarë.

